

URDHËR
Nr. 23, datë 18.1.2021

**PËR NJË NDRYSHIM NË URDHRIN NR. 434, DATË 22.7.2020, “PËR MIRATIMIN E
PËRBËRJES SË KOMISIONEVE MJEKËSORE TË CAKTIMIT TË AFTËSISË PËR
PUNË, TË NIVELIT TË PARË DHE EPROR, PËR VLERËSIMIN E PERSONAVE ME
AFTËSI TË KUFIZUARA”**

(Ndryshur me vendimin nr. 117, datë 19.2.2021)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të neni 4, pika 3, dhe nenit 7, të ligjit nr. 57/2019, datë 18.7.2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”; të nenit 15, të ligjit nr. 8626, datë 22.6.2000, “Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar, të ligjit nr. 8098, datë 28.3.1996, “Për statusin e të verbrit”, të ndryshuar; pikave 2 dhe 7 të kreut II, të vendimit nr. 182, datë 26.2.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e masës, të kriterëve, procedurave e dokumentacionit për vlerësimin dhe përfitimin e pagesës për personat me aftësi të kufizuara, si dhe të ndihmësit personal”,

URDHËROJ:

Në urdhrin nr. 434, datë 22.7.2020, “Për miratimin e përbërjes së komisioneve mjekësore të caktimit të aftësisë për punë, të nivelit të parë dhe epror, për vlerësimin e personave me aftësi të kufizuara”, bëhen ndryshimet si vijon:

1. Në pikën 2, germa “b”, “Komisioni (KMCAP/KMVP) për sëmundjet e përgjithshme”, mbas germës “iii” shtohet germa “iv”, “znj. Flutura Beqo (mjek i përgjithshëm)”.

2. Në pikën 2, germa “d”, “Komisioni (KMCAP/KMVP) për para/tetraplegji”, zëvendësohet me “Komisioni (KMCAP/KMVP) për para/tetraplegji dhe neurologji”, pika “ii”, “z. Drini Dobi zëvendësohet me z. Eris Ranxha (neurolog); shtohet germa iii/1 Z. Bujar Cakani (Neurolog)”.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**MINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu**